



PROCESVERBAL I/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) të jashtëzakonshme për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 09.08.2023
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevxhet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - desha një sqarim për projekt-vendimin e kaluar 2021-2022. A është funksional ai vendim? Sepse nëse ne e bëjmë një ndryshim 2022-tën, s'e di sa mund ti bartim mjetet e 2021-tës. Kjo seancë e jashtëzakonshme nuk është aq urgjente për arsye se po i bie që ju po e mbulon një dështim të atyre që ne ju kemi thënë,që duhet çdo herë me i shiku vendimet para se me i sjell. Edhe mbledhjen e kaluar ju paralajmërova që nuk kalon por ju po doni veç me i mbajte mbledhjet dhe me i kalu vendimet.

Kryesuesi - sa i përket ndryshimit të vendimeve,këtë e sqaron zyrtari ligjor kurse sa i përket mbledhjes së jashtëzakonshme,ne kemi të bëjmë me të hyra vetanake dhe faktikisht ne jemi në muajin e tetë dhe të hyrat vetanake duhet të shpenzohen këtë vit. Për të mos humbur kohë e kemi thirrë këtë mbledhje të jashtëzakonshme.

Avni Bytyqi - neni 4 me hy në fuqi të këtij vendimi që sot miratohet,nëse miratohet nga ky Kuvend,e shfuqizon vendimin e mbledhjes së kaluar dhe në kuadër të këtij projekt-vendimi janë të përfshira edhe mjetet e vitit 2021 dhe të vitit 2022 që të barten për shpenzim për vitin 2023.

Liridon Fandaj - mos është problem nëse nuk e cekim ne që ato të hyra barten prej viti 2021 në këtë vendim dhe prapë duhet me votu të njëjtin vendim? Nëse ju i keni bërë bashkë vitin 2021 dhe 2022 atëherë edhe në vendim është mirë të jenë ato bartje sepse barten prej një kodi buxhetor prapë.

Labinot Halitjaha - ndoshta nuk është e mirë që ju kemi thirr për një mbledhje të jashtëzakonshme por ne si Komunë duam që fondet që kanë kalu nga viti 2021 dhe 2022 si pjesë e suficitit dhe fondet e fundit të vitit që nuk mund të shpenzohen në atë vit.Ne kemi

pas probleme me rregullat që kanë ndryshe në pjesën e vitit të kaluar nga qeveria,që fondet e vitit 2021 të mos shfrytëzohen dhe kanë kalu në faza të ndryshme,deri sa u marrë një vendim në parlament që fondet e vitit 2021 të barten në vitin tjetër fiskal. Problem tjetër ka qenë që rregullat për kode të investimeve dhe pjesës së sanimeve, të mallrave dhe shërbimeve kanë ndryshu në pjesën e qeverisjes,që neve na kanë kriju këto probleme dhe jo vetëm neve si Komunë por edhe Komunave tjera. Te rasti ku jemi në fjalë,janë të hyrat e vitit 2021 dhe 2022 të cilat i kemi bartë në seancën e kaluar për këtë vit fiskal. Ndryshimi i këtyre dy kodeve bëhet sepse pjesa ku ka qenë sanimi i rrugëve nuk është pranuar si investim kapital dhe ne duhet me i harmonizua rregullat si Komunë me ministrinë. Nëse ne nuk i harmonizojmë rregullat,ne nuk mund ti marrim paratë dhe të vazhdojmë me programin komunal. Besoj që si ne si pozitë dhe ju opozita,dëshira juaj është që të hollat mos me u bartë dhe me u zhvillu Komuna. Nëse ka mundësi të na kuptoni,që këto të hyra me i bartë në dy projekte tjera të cilat si projekte janë pothuaj të njejta dhe vetëm ndryshojnë kodet buxhetore.

Liridon Fandaj - unë e kontestova vendimin sepse në vendim po shkruan vetëm 2022 dhe te projektet kapitale e ke bë 2021-2022. Kur ta merr ky vendim ligjshmërinë në Ministri të Pushtetit lokal,mos po kthehet se nuk e ke përshkrua por e ke bë vetëm 2022? por realisht këto të hyra janë edhe të 2021-tës. Korrigjon vendimin që mos të kthehet prapë.

Labinot Halitjaha - ka mund ta bëj një gabim teknik ZKF-ja por me vendim 2021 dhe 2022 kalojnë në vitin 2023.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e rendit të ditës.

16 për, 4 kundër, 2 abstenime
Miratohet projekt-vendimi

Takimi përfundoi: 10:20
Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj